

Shtojca A - Oraret e operimit të sistemit AIPS EURO

Ora	Ngjarja	Operacionet
08:20 – 8:30	Fillimi i procedurave të hapjes së ditës	Intervali gjatë të cilit kryhet hapja e ditës (Start Of Day) në sistemin AIPS EURO; Start of day duhet të jetë kryer brenda orës 8:30; Sistemi AIPS EURO pranon vetëm veprimet shtim/pakësim të fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësve.
08:20 – 08:35	Fillimi i operimit	Intervali gjatë të cilit kryhet hapja e ditës së punës (Open For Business) në sistemin AIPS EURO; Open For Business kryhet pasi të jetë kryer Start Of Day; Pjesëmarrësit mund të dërgojnë dhe të marrin pagesa si dhe të pranohen shtim/pakësim të fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësve.
15:00	Afati maksimal i pranimit të urdhrave për pakësim fondesh (me banka korrespondente)	Orari kufi (maksimum) pranimit të urdhrave nga pjesëmarrësit për pakësimin e fondeve në llogari nëpërmjet bankave korrespondente. Përtej këtij orari nuk garantohej që urdhri për transferim për pakësim të fondeve nëpërmjet bankave korrespondente mund të kryhet brenda asaj dite pune.
16:15	<i>Cut-off</i> paraprak	Sistemi AIPS EURO nuk pranon më pagesa për klientët. Sistemi AIPS EURO pranon vetëm instruksione për shtim të fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit.
16:20	<i>Cut-off</i> përfundimtar Fund i operimit në sistem	Sistemi AIPS EURO përllogarit rezultatet/pozicionet e pjesëmarrësve për instruksionet e pagesave të shlyera gjatë ditës së punës. Sistemi AIPS EURO pranon vetëm instruksione për shtim të fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit.
16:30 – 16:45	Mbyllja e ditës së punës	Kryhen procedurat e mbylljes së sistemit, gjenerohen raportet e fundit të ditës, dërgohen gjendjet e llogarive me mesazhe konfirmimi SWIFT. Sistemi AIPS EURO nuk pranon instruksione për shtim të fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit për atë ditë pune.

Shënim: Përtej orareve kufi të përcaktuara në tabelën e mësipërme, çdo instruksion për shtim/pakësim të fondeve në llogarinë e shlyerjes së pjesëmarrësit, do të ekzekutohet në sistemin AIPS EURO në ditën pasardhëse të punës.